



Planuar / Doretuar Priljena/Prodato Received/Delivery		11-05-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKIMSACK	2729/2022		1/6	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.306/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën e datës 29.03.2022 me numër A.nr.306/2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi në në Komunë të Podujevës, kundër Vendimit Nr.13-112/12-0018937/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.306/2022 e datës 29.03.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. **ANULOHET** Vendimi Nr.13-112/12-0018937/22 i datës 14.03.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës si dhe procedura e rekrutimit me numër reference RN00007789 për pozitën e punës „Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale”.
- III. **OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Podujevës që të ndërmerë të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja me date 06.12.2021 ka aplikuar në pozitën: "Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale", te shpallur më datë 01.11.2021 i hapur me numër reference RN00007789

nga Komuna e Podujevës, per aplikim nga datë 22.11.2021 deri me datë 06.12.2021, i cili ka marrë pjesë në fazat e procedurës së rekrutimit.

Me datë 07.03.2022 përmes faqes zyrtare të Komunës së Podujevës është njoftuar për kandidatin e suksesshëm për pozitë: "Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale", kundër mos përzgjedhjes së saj në këtë pozitë me datë 08.03.2022 në Komisionin e Pranimit në Komunë të Podujevës i cili me datë 14.03.2022 ka nxjerrë Vendimi Nr.13-112/12-0018937/22, me të cilin i ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar duke lenë në fuqi Njoftimin e datë 07.03.2022.

Ankuesja kundër Vendimit të datës 14.03.2022 ka parashtruar ankesë me datë 29.03.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e protokolluar me numër 1664/2022, me pretendime ankimore se procedura e rekrutimit nuk është zhvilluar në pajtim me ligjin ne fuqi për mos njoftimin nga njësia e personelit për rezultatin final dhe pikët e arritura nga kjo procedure e rekrutimit, siç është njoftuar me të njëjtën datë për pozitën "Specialist i Përkthimeve të Interpretimit", të rekrutimit dhe se kandidati i suksesshëm nuk është përfshirë në listën e ngushtë të aprovuar por i përfshire ne listën e kandidateve të refuzuar, dhe i cili pas ankesës është përfshirë në testim me shkrim dhe me gojë, dhe nga ky test ka qene i vlerësuar i dyti me pikë sipas njoftimit të datës 02.03.2022 të Njësisë së Personelit , duke dyshua se nga intervista me gojë nuk ka qene më i mirë se ankuesi për shkak të kohës shumë të vogël të qëndrimin para komisionit në intervistë në krahasim me kohen e tij.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Podujevës, ndërsa kjo fundit më datë 19.04.2022, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat lidhur me çështjen në shqyrtim.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokolli 1664/2022 të datës 29.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i shpallur me datë 22.11.2021 deri me datë 06.12.2021 me numër reference RN00007789; Aplikacioni ne forme elektronike -SIMBNJ, i datës 20.12.2021; Rezultati i vlerësimit i datës 01.03.2022 nga testi me shkrim; Njoftimi i datës 02.03.2022 nga testi me shkrim për arritjen e pikëve; Ankesa e datë 8.03.2022; Rezultati i vlerësimit , i datës 07.03.2022; Listën e kandidateve të aprovuar përmes Sistemit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Vendimi Nr.13-112/12-0018937/22 i datës 14.03.2022 i Komisionit të Pranimit të Komunës së Podujevës; Njoftimin e datës 24.12.2021 me Nr. 288/2021 lidhur me verifikimin paraprak; Vendimi i komisionit përzgjedhës i datës 11.02.2022; Njoftimi për intervistës me gojë i datës 04.03.2022;përgjigje ne ankese e datës 19.04.2022 nr. protokolli 2200/2022 për KPMSHCK-së; Lista e aplikative për mes sistemit SIMBNJ-së; Aplikacioni I.U.; Diploma e datës 15.02.2009, lëshuar nga Universiteti AAB me NR. 09/09, nga studimet themelore për z. I.U. dhe Diploma e masterit e datë 14.11.2016 nr.D-41/16; Diploma e datës 16.05.2014, lëshuar nga Universiteti AAB

me NR. 898/14; Vërtetim i datës 20.09.2019; Akt emërimi i datës 06.03.2017; Rekomandim i datës 25.05.2021; Vërtetim i datës 23.11.2019; Rekomandim i datës 25.05.2021; Certifikatë e datës 09.11.2021, nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Aplikacioni i ankuesit; Diploma e datës 11.03.2011 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me NR.1352, nga studimet themelore për ankuesen; Diploma e datës 29.04.2014 lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", me NR.3970, nga studimet themelore për ankuesen; Certifikatë 2008/2009; Certifikatë e datës 31.03.2017 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikatë e datës 08-26.11.2021; Vërtetim i datës 20.04.2014; Referencë e datës 31.12.2016 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega Podujevë; Certifikatë e datës 26.11.2021 nr. 8966/2021 lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë Dega Podujevë; Letër Motivuese e datës 06.12.2021 me CV-në e ankueses; Dëshmi E-mail i datës 14.03.2022 mbi pranimin e Vendimit të Komisionit pranues; Provat shtesë të datës 11.05.2022 në forme elektronike.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtoi dhe analizoi me kujdes provat e lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se Komuna e Podujevës, më datë 01.11.2021 ka shpallur Konkursin e hapur me numër reference RN00007789 për pozitën e punës "Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale", *klasa profesional 2*. Konkursi ka qenë i hapur për aplikim nga data 22.11.2021 deri me 06.12.2021. Në këtë konkurs kanë aplikuar dyzet(40) kandidatë duke përfshirë edhe ankuesen. Në listën e kandidatëve të aprovuara aplikacionet nga sistemi SIMBNJ-së janë përfshirë tetë (8) kandidatë ku dhe ankuesja ka qenë e listuar e dyta, po ashtu me njoftimin e datë 24.12.2021 të njësisë së burimeve njerëzore është formuar lista e ngushtë ku në këtë njoftim është sqaruar se tre (3) prej kandidatëve janë përfshirë në listë të ngushtë pas shqyrtimit e tetë(8) ankesave prej të cilave tri(3) janë aprovuar duke u përfshirë kandidati i suksesshëm dhe pesë(5) janë refuzuar si të pa bazuara, në kuadër të së cilës listë është edhe ankuesja e cila ka qenë edhe pjesë e të gjitha fazave tjera të konkurrimit, respektivisht në testimin me shkrim i mbajtur më datë 01.03.2022 dhe intervistën me gojë i mbajtur më datë 04.03.2022. Sipas Listës përfundimtare të Komisionit të Pranimit i themeluar sipas Vendimit me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevas, kandidati me i vlerësuar duke u renditur si i pari në listë është me gjithsej 85.6 pikë të përgjithshme nga testi me shkrim dhe me gojë, ndërsa ankuesja është vlerësuar si kandidati i dytë me gjithsej 59.04 pikë. Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës, më datë 07.03.2022 ka bërë publikimin e njoftimit për kandidatin e suksesshëm.

Ankuesja e pakënaqur me Njoftimin e datës 07.03.2022, parashtron ankesë më datë 08.03.2022 pranë Komisionit të Pranimit i cili me Vendimin Nr.13-112/12-0018937/22 të datë 14.03.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 07.03.2022.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duke kundërshtuar Vendimin Nr.13-112/12-0018937/22 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Pranimit, me pretendimet ankimore se ka pas shkelje ligjore lidhur me procedurën rekrutuese për pozitën e punës "Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale", që nga faza e verifikimit të aplikacioneve e deri të shpallja e rezultatit përfundimtar. Me tej shton se rezultatet e



grumbulluara nga intervista nuk janë komunikuar në asnjë formë, se kandidati i suksesshëm nuk është përfshirë në listën e kandidatëve të aprovuar të aplikacionit, por ishte i përfshirë në listën e kandidateve të refuzuar, dhe i cili pas ankesës është përfshirë në testim me shkrim dhe me gojë, dhe nga ky test ka qenë i vlerësuar i dyti me më shumë pikë sipas njoftimit të datës 02.03.2022 të Njesisë së Personelit, duke dyshuar se nga intervista me gojë nuk ka qenë më i mirë se ankuesja për shkak të kohës shumë të vogël të qëndrimit para komisionit në intervistë në krahasim me kohën e saj.

Sipas Konkursit me numër reference RN00007789 për pozitën e punës "*Specialist i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale*", si kushte formale janë kërkuar: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, në fushë të punës sociale, psikologjike, drejtësi pedagogji ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, ...Përvoja e punës së kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*".

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se rezultatet e grumbulluara nga intervista nuk janë komunikuar për kandidatët, organi i punësimit në përgjigjen në ankesë deklaroi se njoftimi i kandidatëve bëhet përmes sistemit elektronik SIMBNJ, mirëpo nga shkresat e lëndës Kolegji nuk ka gjetur asnjë dëshmi që kandidatët respektivisht ankuesja të jetë njoftuar lidhur me rezultatin e testit me shkrim, intervistës me gojë dhe rezultatin e jetëshkrimit, e si rrjedhojë Kolegji vlerëson se njësia përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me kërkesat ligjore të përcaktuara me nenin 25 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është theksuar se: *Në çdo rast, Njësia Përgjegjëse njofton individualisht çdo kandidat pjesëmarrës në fazën e vlerësimit. Njoftimi përfshin renditjen e kandidatit dhe rezultatin e detajuar të vlerësimit të kandidatit në çdo hap të vlerësimit*", kështu që pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i bazuar.

Në funksion të shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimit të goditur me ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në *Shtojcën 2* të kësaj Rregullore, për pozitën e punës "*Specialist i Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale*", e renditur me kodin 12 fusha e arsimit të kërkuar është fakulteti i Psikologjisë, Punë Sociale dhe të ngjashme, ndërsa sipas Konkursit me numër reference RN00007789, si fushë e arsimit është përcaktuar *Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to, në fushë të punës sociale, psikologjike, drejtësi pedagogji ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare*, e që sipas vlerësimit të Kolegjit organi i punësimit ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Rregullore (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pasi që kriteret e përcaktuara me konkurs nuk janë në harmoni me kriteret e përcaktuara me këtë rregullore.

Po ashtu duke ju referuar kriterëve të përcaktuar me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës lidhur me pozitën e punës "*Specialist i Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale*", Kolegji bazuar në provat material gjen se edhe ankuesja dhe kandidati i suksesshëm nuk kanë përmbushur kriterin lidhur me fushën e arsimit, respektivisht ankuesja sipas Diplomës me nr.1352 të datës 11.03.2011 ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik në Universitetin "Hasan Prishtina" në Prishtinë dhe mori titullin Bachelori i Drejtësisë, si dhe Diplomën nr.3970 e datës 04.04.2016 dhe mori titullin Jurist i Diplomuar - Bachelori (240 ECTS),

ndërsa kandidati i suksesshëm sipas Diplomës me nr.091/09 të datës 11.04.2009 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Kriminalistikës në Universitetin "AAB", në Prishtinë dhe ka marr titullin Baçelor i Kriminalistikës, si dhe Diplomën me nr.898/14 të datës 04.08.2014 të Kolegjit "AAB", me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore universitare në programin Juridik i Përgjithshëm dhe ka marr titullin „LLB në Juridik“, po ashtu kandidati i përzgjedhur posedon Diplomën me nr.41/16 të datës 14.11.2016 të Kolegjit "ISPE", me te cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet master në programin Studime Evropiane dhe mori gradën Master në Studime Evropiane në Specializim ne Politikat e BE.

Lidhur me kriterin formal të përvojës së punës "*Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë*", Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se përvoja e punës për pozitën në fjalë duhet të jetë në fushën që zhvillohet procedura rekrutuese, ndërsa në bazë të vlerësimit të provave të lëndës të dy kandidatëve të përfshirë në listën e shkurtër dhe që kanë vazhduar konkurrimin, Kolegji ka gjetur që kandidati i përzgjedhur/fitues si dhe ankuesja nuk kanë plotësuar kriterin e përvojës së punës në fushën e caktuar, kështu që mbi këto arsye rrjedhë se Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Podujevës me përfshirjen në listën e shkurtër të kandidatëve të lartcekur që nuk kanë plotësuar kushtet e konkursit, ka vepruar në kundërshtim me nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë..* ndërsa Komisioni i Pranimit nuk ka respektuar dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht është theksuar se: *Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, ... bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive.*

Po ashtu, Kolegji nga shkresat e lëndës ka konstatuar se me Vendimin me Nr.02-020/04-0010235/22 të datës 11.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Podujevë për themelimin e Komisionit të Pranimit nuk janë përcaktuar edhe zëvendësuesit e anëtarëve të Komisionit të Pranimit ashtu siç përcaktohet me neni 18 paragrafi 6 ndërlidhur me nenin 17 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Bazuar në konstatimet si me lartë, e meqenëse janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale gjatë zhvillimit të kësaj procedure të rekrutimit, Kolegji në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3 dhe 1.5 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative konstaton së një procedurë rekrutimi e përfshirë më shkelje procedurale dhe shkelje të dispozitave materiale konsiderohet procedure e paligjshme, kështu që Kolegji bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.306/2022

Zyle Millaku Gojnovci


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.